



Datë: 15.04.2025
Numër protokolli: 2497/2025

A.nr.303/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka–në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.303/2025 të datës 12.02.2025 të parashtruar nga ankuesja S.G.G. të cilën me autorizim e përfaqëson avokatja Miralba Nikçi nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.303/2025 e datës 12.02.2025 e parashtruar nga ankuesja S.G.G.

II. Detyrohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në atë mënyrë që ankueses ti kompensohet shtesa për punën me vëllim të shtuar sipas Marrëveshjes për punë me vëllim të shtuar me numër protokolli 1359 të datës 09.07.2024 dhe atë për periudhën 01.07.2024 deri më datë 31.12.2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile S.G.G. (*tutje referuar vetëm* ankuesja), më datë 10.02.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është pranuar me datë 12.02.2025 me numër protokolli 946/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me mos realizimin e shtesës për punën me vëllim të shtuar sipas Marrëveshjes me numër protokolli 1359 të datës 09.07.2024, e njëjta kërkon ti aprovohet ankesa dhe të detyrohet Komuna e Fushë Kosovës në përmbushjen e obligimit kompensimit për periudhën 01.07.2024 deri më datë 31.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 05.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Fushë Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 25.03.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 946/2025 të datës 12.02.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim nga S.G. për M.N. i datës 03.02.2025; Propozim për pagesë të vëllimit në punë me numër protokolli 918 i datës 08.07.2024; Marrëveshje për punën me vëllim të shtuar me numër protokolli 1359 i datës 09.07.2024; Vendim i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës me numër protokolli 1359 i datës 09.07.2024; E-mail nga A.T. për M.K. etj. i datës 15.08.2024; E-mail nga M.K. për A.T. etj. i datës 09.08.2024; E-mail nga S.G. për M.N. i datës 06.02.2025; E-mail nga V.K. për S.G. i datës 06.02.2025; E-mail nga S.G. për B.O. etj. i datës 06.02.2025; Pliko me numër R6876384 i datës 10.02.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 18.02.2025; Përgjigje në ankesë i datës 05.03.2025; E-mail nga V.K. për C.Z. i datës 26.02.2025; Akt Emërim i S.G.G. i datës 20.07.2016; Përshkrimi i detyrave të punës; Formular i shpenzimit të departamentit divizionit ose sektorit; E-mail nga V.K. për C.Z. i datës 25.02.2025; E-mail nga C.Z. për V.K. i datës 25.02.2025; E-mail nga V.K. për C.Z. i datës 25.02.2025; Lista e pagave e muajit Korrik deri Dhjetor 2024; Lista e pagave e muajit Janar deri Shkurt 2025; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 1987/2025 i datës 25.03.2025;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 20.07.2016 është e punësuar në pozitën “*Inspektore për energji elektrike*” në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Fushë Kosovës. Tutje nga shkresat e lëndës konstatohet, se sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës me numër protokolli 1359 të datës 09.07.2024 ankuesja është caktuar Menaxhere e Projektit nga data 01.07.2024 deri me datë 30.06.2025. Ndërsa më datë 09.07.2024 është nënshkruar Marrëveshja për punën me vëllim të shtuar me numër protokolli 1359 mes ankueses dhe Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, pasi që e njëjta angazhohet si Menaxhere e Projektit nga data 01.07.2024 deri me datë 30.06.2025.

Ankuesja përmes e-mailit zyrtar të datës 06.02.2025 i është drejtuar Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës me kërkesë lidhur me kompensimin sipas Marrëveshjes për punën me vëllim të shtuar me numër protokolli 1359 të datës 09.07.2024 dhe atë nga data 01.07.2024 deri me datë 31.12.2024.

Ndërsa me datë 06.02.2024 Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës i përgjigjet si në vijim citoj: *E nderuar ashtu siç jeni në dijeni edhe ju ne zyra për burime njerëzore e kemi përcjellë materialin për vëllimin e punës në Thesar andaj përgjigja për mos realizimin për këtë periudhë është mungesa buxhetore.*

Në bazë të provave të lëndës të ofruara nga organi i punësimit, konkretisht listës së pagave nga muaji Korrik deri Dhjetor 2024 ankuesja nuk është kompensuar sipas Marrëveshjes për punën me vëllim të shtuar me numër protokolli 1359 të datës 09.07.2024 dhe atë nga data 01.07.2024 deri me datë 31.12.2024.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillim e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me mos realizimin e shtesës për punën me vëllim të shtuar sipas Marrëveshjes me numër protokolli 1359 të datës 09.07.2024, e njëjta kërkon ti aprovohet ankesa dhe të detyrohet Komuna e Fushë Kosovës në përmbushjen e obligimit kompensimit për periudhën 01.07.2024 deri më datë 31.12.2024.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses për kompensimin e mjeteve financiare në emër të shtesës për punë me vëllim të shtuar ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (*i aplikueshëm nga data 05.02.2023*), përkatësisht nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe paragrafi 6 ku përcaktohet se: 1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: *1.6. shtesa për vëllimin e punës; 6. Rregullat për fitimin, vlerën e shtesës si dhe periudhën e përfitimit përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe me pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike.* Rrjedhimisht, me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.28/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, përkatësisht nenit 8 përcaktohet se: *1. Organizatat buxhetore, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve civil, apo pozitive të paplotësuar për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta; 2. Shtesa për vëllimin e punës përfitohet nga nëpunësit civil, për punën e kryer për shkak të rritjes së vëllimit të punës dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, ndërsa me nenin 9 paragrafi 2, 5 dhe 6 të rregullores se njëjtë përcaktohet se: 2. Udhëheqësi i Njesisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit; 5. Shtesa për vëllimin e punës miratohet me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me nëpunësin civil për të punuar me vëllim të shtuar, sipas Shtojcës 1, pas konfirmimit nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa se nuk është tejkaluar limiti buxhetor, konform njoftimit të përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni; 6. Vlera e shtesës për vëllim të punës është deri në njëzetë përqind (20%) e pagës bazë të nëpunësit civil.*

Duke u bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të administruara të lëndës rezulton se pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e mjeteve financiare në emër të shtesës për punën me vëllim të shtuar është i drejtë dhe i bazuar, ngase ashtu sikurse është thënë më lartë në arsyetim të këtij vendimi, ankuesja sipas Marrëveshjes për punën me vëllim të shtuar me numër

protokolli 1359 të datës 09.07.2024 është autorizuar që t'i ushtroj edhe detyrat dhe përgjegjësi tjera shtesë, ku dhe me nenin 5 të kësaj marrëveshje në mënyrë shprehimore është përcaktuar se ankuesja për punën me vëllim të shtuar përfiton shtesë mujore 20% të pagës bazë.

Andaj, duke qenë se nga shkresat e lëndës rezulton se Marrëveshja për punën me vëllim të shtuar me numër protokoli 1359 të datës 09.07.2024 e lidhur në mes të ankueses dhe organit përkatës të punësimit, nuk është kontestuese për palët në procedurë, ashtu sikurse as ushtrimi faktik i detyrave dhe përgjegjësi shtesë nga ankuesja, si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 9 paragrafi 2, 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja me datë 12.02.2025 për kompensimin e mjeteve financiare në emër të shtesës për punën me vëllim të shtuar është e bazuar.

Kështu që, theksuar si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj Kryetarin e Komunës dhe Udhëheqësen e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet administrative për kompensimin e ankueses sipas Marrëveshjes për punën me vëllim të shtuar me numër protokoli 1359 të datës 09.07.2024 për periudhën nga data 01.07.2024 deri me datë 31.12.2024.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.303/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses të autorizuar të ankueses, avokates Miralba Nikçi;
- Komunës së Fushë Kosovës (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.